



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Nr. 4/31 prot.

Shkodër, më 19.12.2022

V E N D I M

Nr. 268, datë 19 . 12 .2022

"Për propozimin e trajtimit të veçantë financiar të komisioneve të veçanta të USH-së"

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 3, pika 1; Statutin e USH-së; Udhëzimin e MARS nr.29, datë 10.09.2018, Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 19.12.2022

Vendosi:

1. T'i propozojë Bordit të Administrimit të vendosë trajtimin e veçantë financiar të stafit akademik (honorare) për punën e bërë jashtë kohës normale të punës për pjesëmarrjen në Këshilla dhe komisione të veçanta si më poshtë:
 - a. Anëtarët e Këshillit të Etikës: - 10000 lekë për çdo mbledhje Këshilli, deri në tetë mbledhje në vit.
 - b. Anëtarët e Komisionit të përhershëm për garantimin e standarteve dhe cilësisë së USH-së: - 10000 lekë për çdo mbledhje komisionit, deri në tetë mbledhje në vit.
 - c. Anëtarët e komisionit të përhershëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë së USH-së dhe marrëdhëniet me studentët : - 10000 lekë për çdo mbledhje komisioni, deri në tetë mbledhje në vit.
 - d. Anëtarët e Komisioneve institucionale "ad Hoc" : - 10000 lekë për çdo mbledhje komisioni, deri në tetë mbledhje në vit.
 - e. Anëtarët e komisioneve të Senatit Akademik: - 2000 lekë për çdo mbledhje.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

